



REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT
Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali - Prishtinë



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICUSKI INSPEKTORAT KOSOVA / POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

Hajvali - Prishtinë

Nr./Bë 04-052-255/1

Data / Datumi 05.04.2024



Referencë: IPK/04042024/DI

Datë: 04.04.2024

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit, Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024), si dhe Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta, Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

Titulli - objekti	- Vlerësimi i kapaciteteve dhe aktiviteteve operative të stacioneve policore
Referenca	- 01/2024
Data e inicimit	- 07.02.2024
Data e raportimit	- 04.04.2024
Arsyet e inicimit	- Në vazhden e monitorimit të angazhimeve në të gjitha nivelet e organizimit policor, më 07.02.2024, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka kërkuar realizimin e inspektimit të jashtëzakonshëm në stacionet policore të rendit për t'u siguruar se të njëjtat janë duke realizuar aktivitete policore në drejtim të krijimit të një ambienti më të sigurt për qytetarët. Inspektimi është fokusuar tek kapacitetet e burimeve njerëzore të angazhuara brenda ndërrimeve të stacioneve, azhurniteti i njësisve policore për të reaguar në raste dhe thirrje të qytetarëve, raportimet mbi aktivitetet e ndërmarra dhe kapacitetet aktive të parkut të automjeteve të stacioneve në shërbim të njësisve policore. Përmes këtij inspektimi është synuar të vlerësohet nëse stacionet janë duke realizuar me sukses objektivat në përbushje të mandatit ligjor.
Objektivat e inspektimit	- Vlerësimi i organizimit, kapacitetet dhe angazhimi i burimeve njerëzore, - Vlerësimi i aktiviteteve operative në ngritjen e nivelit të sigurisë, - Vlerësimi i kapaciteteve dhe kushtet e punës në stacione policore.
Metodologjia e inspektimit	- Gjatë realizimit të punës inspektuese është aplikuar metodologjia si: a) Janë realizuar takime - intervista me mbikëqyrësit e ndërrimit në stacione; b) Janë kontrolluar dhe verifikuar kapacitetet aktive të burimeve njerëzore të stacioneve brenda ndërrimit, prezenca fizike e patrullave policore, gjendja funksionale dhe disponueshmëria e automjeteve; c) Janë siguruar dokumente, apo të dhëna në formë fizike - elektronike, si: Lista e burimeve njerëzore sipas pozitave dhe vendeve të punës, Logu operacional (08.02.2024), Orari ditor, fletë patrullat e ndërrimit, Lista e automjeteve, si dhe kopjet e fletë udhëtimeve.
Subjekti	- Stacionet Policore në Deçan, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjilan, Kaçanik, Kamenicë, Mitrovicë Jug, Pejë, Prishtinë Qendër, Prishtinë Jug, Prishtinë Veriu, Prizren, Prizren Veriu, Suharekë, Shtime, Viti dhe Vushtri.
Afatet e inspektimit	- Fillimi i inspektimit: 08.02.2024, - Përfundimi: 08.02.2024, ora 00.00, - Periudha e mbulimit - Gjendja aktuale.
Kriteri vlerësues	- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë,

(standardi)	- UA nr. 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, - Rregullore për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, - Rregullore për Operativë në Policinë e Kosovës.
Ekipi realizues	- Agron Zekolli dhe Kushtrim Jonuzi (Stacioni Policor - Deçan), - Alban Thaqi dhe Shqiponjë Sopi (Stacioni Policor - Ferizaj), - Shpend Tërziu dhe Valon Kukalaj (Stacioni Policor - Fushë Kosovë), - Arben Vrajolli dhe Sllavisha Deniq (Stacioni Policor - Gjilan), - Xhavit Fetahaj dhe Blerim Oruqi (Stacioni Policor - Kaçanik), - Fitore Gajraku dhe Lenart Berisha (Stacioni Policor - Shtime), - Exhevit Plakolli dhe Mirsad Puqurica (Stacioni Policor - Mitrovicë Jug), - Safet Hoti dhe Teutë Rukolli - Ajeti (Stacioni Policor - Pejë), - Taulant Nika dhe Gëzim Nasufi (Stacioni Policor - Prishtinë Qendër), - Armend Preniqi dhe Zoran Ristiq (Stacioni Policor - Prishtinë Jugu), - Servet Tasholli dhe Gani Zylfaj (Stacioni Policor - Prishtinë Veriu), - Dukagjin Halitaj dhe Mervan Curri (Stacioni Policor - Prizren), - Hazer Mallaku dhe Lulzim Thaqi (Stacioni Policor - Suharekë).
Mbikëqyrur nga	- Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së
Datë	- 04.04.2024



Shkurtesat

IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
LPA	Lista e Personelit të Autorizuar
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
PSO	Procedura Standarde e Operimit
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës

Përmbledhje ekzekutive dhe rekomandimet

Inspektimi nxjerrë në pah se:

- ✚ Në fushën e burimeve njerëzore është hasur mos përputhje ndërmjet kapaciteteve të planifikuara dhe atyre aktuale, mos përputhje këto të përcjella me tejkallim e mungesë në numër të punonjësve. Oraret e aplikuara nga stacionet policore, të cilat mbështeten në kapacitetet që i lejon Struktura organizative, nuk ofrojnë mundësi për prezencë të mjaftueshme të fuqisë aktive të personelit.
- ✚ Në fushën e operativës janë hasur dobësi që lidhen me mos raportimin e aktiviteteve të realizuara përmes formave të fletë patrullave nga ndërrimet e disa stacioneve policore. Po ashtu, janë hasur dobësi në disa raste edhe sa i përket mbajtjes dhe përditësimit të të dhënave të Logut operacional, evidentimin e ngjarjeve në kohë reale në disa prej tyre, si dhe qasjen jo të njëjtë të stacioneve sa i përket formatit të raportimit, që përcillet me dy praktika të evidencës së ngjarjeve (thirrjeve).
- ✚ Sa i përket parkut të automjeteve është identifikuar një numër i madh i automjeteve me gjendje teknike jo të mirë, që ka përgjysmuar kapacitetin funksional dhe që në disa stacione edhe ka pasur ndikim në krijimin e kapaciteteve të duhura për aktivitetet operativ policor më efektiv.



Bazuar në gjetjet, përfundimet dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve:


1. Marrë parasysh tejkallimet dhe mungesat në numrin e punonjësve të stacioneve të inspektuara, IPK i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Personelit dhe Administratës që të ndërmarrë hapat e nevojshëm drejt përmbylljes së procesit të sistemimit dhe ri-sistemimit të burimeve njerëzore, konform Rregullores (MPB) Nr. 02/2023 për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës të Policisë së Kosovës.
2. IPK i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Personelit dhe Administratës, që në koordinim me drejtoritë rajonale policore të plotësojnë nevojat e stacioneve me burime njerëzore siç parashihen me Listën e Personelit të Autorizuar (vëmendja duhet përqendruar tek stacionet, si: Fushë Kosovë, Kaçanik dhe Shtime).
3. IPK-ja i rekomandon komandantëve të stacioneve policore në Suharekë, Prizren Veriu, Kaçanik, Deçan, Gjilan, Prishtinë Jugu, Prishtinë Qendër dhe Ferizaj, që të angazhohen për një menaxhim me cilësor të burimeve njerëzore brenda ndërrimeve.
4. IPK iu rekomandon komandantëve të stacioneve policore në Mitrovicë Jugu dhe Vushtrri, që të kërkojnë nga njësitë patrulluese që në përfundim të ndërrimeve të përmbushin obligimet e tyre në raportimin e aktiviteteve të ndërmarra policore përmes fletëve patrulluese (raportet e patrullave).
5. Për shkak të aplikimit të praktikave të ndryshme të mbajtjes së evidencës së Logut operacional, IPK i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Operacioneve, që të shpërndajë informatën sqaruese në të gjitha drejtoritë rajonale dhe qendrat e radio komunikimit, mbi llojin e evidencave që duhet mbajtur lidhur me thirrjet dhe raportimin, por edhe përmbajtjen e informatave brenda tyre (në disa stacione mbahet logu i reduktuar me informata, por edhe Info ditore, derisa në shumë të tjera mbahet vetëm logu operacional).

Gjetjet kryesore:



1. Organizimi dhe burimet njerëzore

1.1. Elementi më i rëndësishëm i organizatës policore janë burimet njerëzore. Duke konsideruar se paraqesin një vlerë qenësore, shtrohet nevoja për organizimin dhe shpërndarjen e mirëfilltë të tyre. Policia është e organizuar bazuar në Ligjin për Policinë dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës. Stacionet Policore, organizimin e brendshëm dhe sistemin e personelit e bazojnë në Strukturën organizative të aprovuar më 10.07.2023 dhe në Udhëzimin Administrativ nr. 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës. Për të analizuar gjendjen sasore të burimeve njerëzore, numri i planifikuar i personelit me Strukturë Organizative dhe LPA, është krahasuar me numrin e burimeve njerëzore të prezantuara në Raport vjetor (31 dhjetor 2023). Edhe pse për 17 stacionet policore të inspektuara parashihen të angazhohen 1.701 punonjës, të dhënat nga Raporti vjetor për vitin 2023 pasqyrojnë se stacionet kanë 2.036 punonjës, duke e tejkaluar numrin e paraparë për +16.4%.



1.2. IPK ka analizuar gjendjen e burimeve pranë stacioneve edhe sipas kategorisë së tyre. Nëse krahasojmë gjendjen e burimeve njerëzore na pasqyrohet kjo gjendje:

- Kategoria A e stacioneve policore të inspektuara rezultojnë të ketë në masë të përgjithshme tejkalim të numrit të burimeve njerëzore të sistemuara në masën prej +20.4% edhe pse jo të gjitha kanë burime më shumë krahasuar me LPA siç është rasti me Fushë Kosovën që ka për -5.5% më pak.
- Kategoria B e stacioneve policore të inspektuara rezultojnë të ketë në masë të përgjithshme tejkalim të numrit të burimeve njerëzore të sistemuara në masën prej +9.7% edhe pse jo të gjitha kanë burime më shumë krahasuar me LPA siç është rasti me Kaçanikun dhe Suharekën me -10.9%, përkatësisht -1.2%.
- Stacioni Policor i Shtimes nga kategoria C e stacioneve ka një mungesë në masën prej -16.4% të punonjësve krahasuar me numrin e paraparë me LPA (për gjendjen sipas stacioneve, referoju të dhënave në shtojcë 1).

1.3. Për mbërmbjen e 8 shkurtit të këtij viti kur edhe është realizuar inspektimi, janë analizuar oraret ditore të ndërrimeve për të identifikuar e vlerësuar gjendjen aktuale të kapaciteteve aktive operative të 17 stacioneve. Në 15 stacione është hasur duke u aplikuar orari i punës në tre ndërrime në kohëzgjatje me nga tetë (8) orë secila brenda ciklit 24 orë¹, derisa në dy stacione tjera (Mitrovicë Jugu dhe Vushtrri) ka qenë duke u aplikuar orari i punës në dy (2) ndërrime me nga 12 orë brenda ciklit 24 orë². IPK ka vlerësuar kapacitetet aktive të stacioneve në ndërrimin e II-të të datës 08.02.2024. Inspektimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore të 17 stacioneve policore vë në pah se kapacitetet aktive të tyre në detyrë brenda ndërrimit të II-të kanë qenë në masën prej 74% të kapaciteteve të përgjithshme të ndërrimeve. Kur krahasojmë kapacitetet e tilla sipas kategorisë së stacioneve, atëherë pasqyrohet se:

- Stacionet e kategorisë A në ndërrimin e II-të kanë pasur të angazhuara mesatarisht 74% të kapaciteteve të përgjithshme të ndërrimit,


¹ Ndërrimi I (07.00-15.00), ndërrimi II (15.00-23.00) dhe ndërrimi III (23.00-07.00).

² Ndërrimi I (07.00-19.00) dhe ndërrimi II (19.00-07.00).

(b) Stacionet e kategorisë B në ndërrimin e II-të kanë pasur të angazhuara mesatarisht 71% të kapaciteteve të përgjithshme të ndërrimit,

(c) Stacioni Policor i Shtimes nga kategoria C e stacioneve në ndërrimin e II-të ka pasur të angazhuara 78% të kapaciteteve të përgjithshme të ndërrimit.

1.4. IPK ka bërë një renditje të stacioneve sipas gjendjes së pasqyruar të tyre me burime aktive brenda ndërrimeve. Nga diagrami 2 pasqyrohet se Mitrovicë Jugu dhe Vushtrria kanë pasur më shumë fuqi aktive gjatë ndërrimit në masën prej 98%, përkatësisht 96% të kapaciteteve të ndërrimit. Dhjetë (10) stacione policore kanë pasur kapacitete aktive brenda ndërrimit nën mesataren e përgjithshme prej 74%. Janë dy stacione policore që kanë pasur kapacitete nën 50%, përfshirë Prizren- Veriu dhe Suharekën me 40% të kapaciteteve brenda ndërrimit (për më tepër të dhëna referoju shtojcës 2).



1.5. Stacionet policore kanë për detyrë të mbulojnë zonat e përgjegjësive me patrulla policore të cilat duhet të jenë të angazhuara 24 orë. Njësitë e këtyre stacioneve për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike kanë të përcaktuara detyrat policore me orare ditore të cilat duhet realizuar gjatë ndërrimeve të tyre, nëpërmjet aktiviteteve policore patrulluese. IPK ka kontrolluar oraret e ndërrimit të II-të të datës 8 shkurt dhe ka analizuar përbërjen e ekipeve patrulluese në kuadër të ndërrimit. Në ndërrimin e inspektuar, në 17 stacione janë hasur duke operuar 54 njësi patrulluese, nga të cilat, 38 në zonat e përgjegjësive së nëntë (9) stacioneve të kategorisë A, 14 në zonat e përgjegjësive së shtatë (7) stacioneve të kategorisë B dhe 2 në zonën e përgjegjësive së një stacioni të kategorisë C. Me poshtë pasqyrohet mesatarja e patrullave sipas kategorisë së stacioneve”

(a) Stacionet policore të kategorisë A kanë operuar mesatarisht me nga katër (4) njësi patrulluese (Prishtinë Jugu, Mitrovicë Jugu, Prishtinë Qendër, Ferizaj, Prizren kanë mobilizuar më shumë se 4 njësi, derisa Fushë Kosova dhe Peja kanë pasur të angazhuara më pak se 4 patrulla),

(b) Stacionet policore të kategorisë B kanë operuar mesatarisht me nga dy (2) njësi patrulluese (Vushtrri dhe Kamenica kanë mobilizuar më shumë se 2 njësi, derisa Deçani, Kaçaniku, Prizren Veriu dhe Suhareka kanë pasur të angazhuar më pak se 2 patrulla),

(c) Stacioni Policor i Shtimes nga kategoria C e stacioneve ka operuar me dy njësi patrulluese.

2. Aktivitetet operative

2.1. Patrullimet janë aktivitete që realizojnë stacionet, në drejtim të krijimit të një mjedisi të sigurt për qytetarët. Sipas nenit 3 të Rregullores për Operativë, patrullimi është veprim policor, përmes të cilit mbahet rendi e qetësia publike, sigurohet prona, lëvizja e lirë, kontrolli i kufirit, rregullimi i trafikut, parandalimi e zbulimi i veprave penale, kapja e kryesve të veprave penale, si dhe veprime e aktivitete tjera nga fusha e sigurisë, të cilat bëhen nga Policia në zbatim të ligjit. Në ndërrimin e inspektuar,

ekipet patrulluese kanë operuar me përbërje kryesisht me nga dy (2) e në disa raste edhe me nga tre (3) zyrtarë policor. Stacionet janë hasur duke realizuar aktivitete patrulluese në zonat e tyre të përgjegjësive, duke aplikuar në lëvizje patrullimet mobile me automjete dhe në këmbë, si dhe pika të kontrollit. Nga 54 patrulla të stacioneve sa kanë operuar në ndërrimin e inspektuar, 32 prej tyre kanë qenë mobile me automjete dhe 22 në këmbë (për më tepër mbi angazhimet, referoju shtojcës 3).

2.2. IPK ka verifikuar prezencën e patrullave në orët e mbrëmjes në ndërrimin e II-të të datës 8 shkurt 2024. Pasi është siguruar Orari ditor i angazhimit të patrullave, me ndihmën e mbikëqyrësve të ndërrimit janë verifikuar patrullat në terren. Nga 54 patrulla të parapara në aktivitet patrullues, 51 prej tyre janë hasur duke patrulluar në zonat e përgjegjësive të parapara me Orar, derisa tre (3) patrulla të tjera nuk janë hasur në lokacionet e parapara me Orar, për shkak të angazhimeve të tyre në raste (në Deçan dhe Prizren) dhe transportimin e të ndaluarve në Qendrën e Paraburgimit në Hajvali nga një njësi e Stacionit Policor të Prizrenit.


2.3. Rregullat policore në fuqi parashohin që lidhur me aktivitetet patrulluese, duhet përgatitur raporte të patrullave, të njohura si fletë patrulluese. IPK ka verifikuar nëse zyrtarët e stacioneve kryejnë raportimet e nevojshme sipas detyrave të parapara dhe nëse ato kryhen me kohë. Fillimisht janë siguruar raportet e patrullave mbi ngjarjet e ndërrimit të II-të të datës 08.02.2024, ku janë përfshirë fletë patrullat e ndërrimit të pasdites. Për 54 njësi patrulluese që kanë operuar në këtë ndërrim, IPK ka siguruar 44 fletë patrulla, që pasqyrojnë aktivitetet ditore për detyrat e realizuara të ndërrimit dhe bëhen pjesë e Raportit 24 orë në nivel të stacionit. Përveç stacioneve policore të Mitrovicë Jugu dhe Vushtrri ku nuk është hasur që njësitë patrulluese të aplikojnë mbajtjen e fletë patrullave, të gjitha stacionet tjera aplikojnë mbajtjen tyre.

2.4. Gjatë inspektimit në 17 stacionet e inspektuara janë siguruar logjet operationale për periudhën 24 orë që lidhet me ditën e inspektimit, për t'u siguruar se evidenca është cilësore, e përditësuar me të dhëna mbi thirrjet dhe reagimin policor. Fillimisht është hasur se ka formate të ndryshme të mbajtjes së logut nga stacionet. Përderisa shumica e stacioneve mbajnë logjet e tyre duke regjistruar të gjitha tipat e thirrjeve, në disa të tjera, logu on-line regjistron vetëm thirrjet që rezultojnë me reagim. Tek këto të fundit mbahet edhe një regjistër i thjeshtë që nuk është i lidhur me sistem, por që evidenton të gjitha ngjarjet (info ditore në Gjilan, Kamenicë dhe Viti). Në Suharekë dhe Kaçanik, jo të gjitha ndërrimet aplikojnë mbajtjen e shënimeve në log në kohë reale. Sipas mbikëqyrësve të ndërrimeve, kjo vjen si rrjedhojë e mungesës së burimeve adekuate dhe mungesës së autorizimeve për qasje brenda sistemit që aplikohet. Në përjashtim të ndërrimeve që u potencuan më lartë, në stacione mbahet evidencë në Log, me vërejtje të shumta në disa prej tyre. Edhe përkundër vërejtjeve të mëhershme të IPK-së, në disa stacione, si në: Fushë Kosovë, Pejë, Prishtinë Jugu, Prishtinë Veriu, Prizren, Prizren Veriu, shumë thirrjeve të regjistruara në Log nuk u pasqyrohet koha e arritjes së njërive policore në vendngjarje. Rubrikat adekuate për shënimin e detajeve rreth kohës së reagimit dhe arritjes në vendin e ngjarjes janë hasur të zbrazëta, ose detajet për kohën e reagimit janë shënuar nëpër rubrika tjera.

2.5. Me qëllim të vlerësimit të efektivitetit të reagimit³ të njërive policore në thirrjet e qytetarëve janë kontrolluar logjet 24 orë të 17 stacioneve policore. PSO - Koha e reagimit përcakton që koha e reagimit për zonat urbane të jetë maksimum 15 minuta dhe për zonën rurale maksimum 30 minuta, varësisht lokacionit ku ndodhë rasti (me përjashtim në disa zona të thella malore e me kushte të papërshtatshme atmosferike). IPK ka përzgjedhur mostra të thirrjeve të qytetarëve dhe reagimit të stacioneve, aty ku ka qenë e mundur të nxirret koha e reagimit. Është matur koha e reagimit në 157

³ Koha e reagimit llogaritet nga pranimi i informatës nga QOKR-ja, mbikëqyrësi, apo Policia në ndonjërin nga format e komunikimit, koha e dhënies së informatës tek patrulla apo njësi që ngarkohet, koha e nisjes së patrullës/njësisë së ngarkuar dhe arritja në vendngjarje.

mostra⁴ nga logjet e 14 stacioneve, meqë në tre të tjera ka pasur mungesë të dhënash cilësore, apo nuk ka pasur thirrje për reagim policor. Koha e përgjithshme mesatare e reagimit të njërive policore në vend ngjarje ka rezultuar të jetë 11.2 minuta, apo 11 minuta e 12 sekonda. Duke iu referuar diagramit 3, pasqyrohet se kohën më të shtyrë të reagimit e ka regjistruar Stacioni Policor i Prishtinës Veriu dhe Peja me 16.6 minuta, përkatësisht 14.8 minuta (për më tepër të dhëna, referoju shtojcës 4).



3. Automjetet në funksion të aktiviteteve operative


3.1. Se çfarë është gjendja e flotës operative të stacioneve, IPK ka analizuar raportin ndërmjet numrit të automjeteve dhe numrit të punonjësve. Në nivel të 17 stacioneve vërehet se mesatarisht një automjet është në dispozicion për 12 punonjës policor (1:12), por jo të gjitha stacionet kanë këtë raport, meqë ka një shpërndarje jo të balancuar. Stacionet policore që kanë një raport më të pavolitshëm ndërmjet numrit të punonjësve dhe numrit të automjeteve renditen kështu: Deçani, Prishtinë Veriu, Kamenica, Prishtinë Qendër, Prishtinë Jugu dhe Vitia. Ky raport pasqyron se këto stacione kanë nevojë për numër më të madh të automjeteve.

Tabela nr . 1 - Të dhëna mbi parkun e automjeteve dhe disponueshmërinë

Stacioni	Punonjës	Automjete	Raporti	Funksion	%	Raporti
Ferizaj	156	19	1:8	8	42.1	1:20
Fushë Kosovë	119	10	1:12	7	70.0	1:17
Gjilan	184	15	1:12	6	40.0	1:31
Mitrovicë J.	148	16	1:9	9	56.3	1:16
Pejë	165	15	1:11	6	40.0	1:28
Prishtinë J.	178	13	1:14	3	27.1	1:59
Prishtinë Q.	184	12	1:15	7	58.3	1:26
Prishtinë V.	123	7	1:18	5	71.4	1:25
Prizren	156	16	1:10	8	50.0	1:20
Deçan	74	4	1:19	2	50.0	1:37
Kaçanik	57	5	1:11	5	100.0	1:11
Kamenicë	81	5	1:16	4	80.0	1:20
Prizren V	54	7	1:8	4	57.1	1:14
Suharekë	83	9	1:9	4	44.4	1:21
Viti	81	6	1:14	4	66.7	1:20
Vushtrri	145	11	1:13	6	54.5	1:24
Shtime	48	6	1:8	3	50.0	1:16
Gjithsej	2.036	176	1:12	91	51.7	1:22

⁴ Ferizaj (24), Fushë Kosovë (13), Gjilan (11), Mitrovicë Jugu (18), Pejë (5), Prishtinë Qendër (55), Prishtinë Veriu (9), Prizren (7), Deçan (1), Kamenicë (1), Prizren Veriu (2), Suharekë (2), Vushtrri (7) dhe Shtime (2).

	<p>3.2. IPK ka pasur në fokus funksionalitetin e flotës së automjeteve në stacione dhe kapacitetet aktive në funksion të aktiviteteve operative. Jo të gjitha automjetet me të cilat janë ngarkuar stacionet, në ditën e inspektimit kanë qenë në funksion. Mos funksionaliteti i një numri automjeteve ka ndikuar edhe në rënien e fuqisë aktive të flotës së stacioneve. Marrë parasysh se në ditën e inspektimit, 52% e flotës ka qenë funksionale, pasqyrohet se në nivel të 17 stacioneve, mesatarisht një automjet ka qenë në dispozicion për 22 punonjës policor (1:22). Stacionet që kanë pasur një raport më të pavoritshëm ndërmjet numrit të punonjësve dhe numrit të automjeteve funksionale renditen kështu: Prishtinë Jugu, Deçani, Gjilani, Peja, Prishtinë Qendër, Prishtinë Veriu dhe Vushtrria. Ky raport pasqyron se këto stacione kanë nevojë për përmirësim të kapaciteteve aktive të tyre. Stacionet me flotën më jofunksionale në raport me numrin e automjeteve të ngarkuara renditen kështu: Prishtinë Jugu (27.1%), Gjilan (40.0%), Pejë (40.0%), Ferizaj (42.1%) dhe Suhareka (44.4%).</p> <p>3.3. Pasqyra e indikatorëve për gjendjen e flotës së automjeteve tregon se stacionet operojnë me kapacitete të përgjysmuara dhe resurset e kufizuara mund të ndikojnë në efektivitetin në punë. Nga 176 automjete, me të cilat kanë qenë të ngarkuara 17 stacione, 52% e tyre kanë qenë në gjendje funksionale dhe të gatshme për operim (91 sosh). Sa i përket funksionalitetit të flotës aktive të automjeteve sipas kategorisë së stacioneve, inspektimi pasqyron se:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Flota e automjeteve e stacioneve të kategorisë A, e përbërë nga 123 automjete ka qenë funksionale në masën prej 48%, (b) Flota e automjeteve e stacioneve të kategorisë B, e përbërë nga 47 automjete ka qenë funksionale në masën prej 62%, dhe (c) Flota e automjeteve e stacioneve të kategorisë C (e përfaqësuar nga Stacioni Policor - Shtime), e përbërë nga 6 automjete ka qenë funksionale në masën 50%. <p>3.4. Inspektimi i kapaciteteve aktive të flotës së automjeteve pasqyron se në ndërrimin e inspektuar të pasdites të datës 08.02.2024, kanë qenë 91 automjete funksionale në dispozicion të aktiviteteve operative të stacioneve. Verifikimi i realizuar mbi angazhimin e automjeteve brenda ndërrimit ka pasqyruar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) 74% e kapaciteteve aktive (67 automjete) kanë qenë të disponueshme nga njësitë policore të ndërrimit, edhe pse jo të gjitha të shfrytëzuara, (b) 26% e kapaciteteve aktive (24 automjete) kanë qenë në shfrytëzim të stafit komandues të stacioneve dhe njësisve tjera. <p>3.5. IPK ka analizuar kapacitetet aktive dhe të disponueshme nga pjesa funksionale e parkut të automjeteve të stacioneve që ishte gjithsej 91 sosh. Analiza pasqyron se:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Tek nëntë (9) stacionet e kategorisë A, nga 59 automjete funksionale sa kanë pasur ato, 44 prej tyre (75%) kanë qenë në dispozicion të ndërrimit. Stacionet kanë pasur mesatarisht nga pesë (5) automjete në dispozicion. Në ditën e inspektimit, Fushë Kosova, Prishtinë Jugu dhe Prishtinë Veriu kanë pasur numër automjeteve nën këtë mesatare. (b) Tek shtatë (7) stacionet e kategorisë B, nga 29 automjete funksionale sa kanë pasur ato, 21 prej tyre (72%) kanë qenë në dispozicion të ndërrimit. Stacionet kanë pasur mesatarisht nga tre (3) automjete në dispozicion. Deçani, Prizren Veriu e Suhareka kanë pasur numër automjeteve nën mesatare. (c) Stacioni Policor-Shtime nga kategoria C, nga tre (3) automjete funksionale sa ka pasur, dy (2) sosh i ka pasur në dispozicion të ndërrimit (<i>për më tepër referoju shtojcës 4</i>).
--	--

<p>Përfundime</p> 	<p>Nga gjetjet e këtij inspektimi pasqyrohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Në kuadër të 17 stacioneve të inspektuara rezulton të ketë një tejkalim të numrit të burimeve njerëzore në masën prej 16%, edhe pse ka prej tyre që ballafaqohen me mungesë burimesh. Afërsisht 3/4 e tyre (13 nga 17 stacione) kanë më shumë burime njerëzore nga sa parashihen me LPA, derisa afërsisht 1/4 e tyre kanë më pak burime njerëzore se që parashihen me LPA. (b) Burimet e kufizuara në disa stacione policore kufizojnë edhe fuqinë aktive të ndërrimeve, duke sfiduar stacionet në uljen e numrit të njësisve patrulluese, që për pasojë mund të ulin numrin e aktiviteteve brenda zonës së përgjegjësisë. (c) Në matjet e IPK-së për 17 stacione, në ditën e inspektimit ka qenë i angazhuar rreth ¾ e potencialit të burimeve njerëzore të ndërrimit të stacioneve, derisa ¼ ka qenë në pushime, trajnime, etj. Janë identifikuar edhe stacione me kapacitete të përgjysmuara brenda ndërrimit. Janë identifikuar ndërrime kur stacionet kanë operuar me më pak njësi patrulluese, në raport me mesataren për kategoritë përkatëse të stacioneve. (d) Me përjashtim të rasteve kur njësitë patrulluese të disa stacioneve kanë qenë të angazhuar në detyra specifike, njësitë patrulluese të ndërrimit të II-të janë hasur në lokacionet e parapara me orare. (e) Me përjashtim të ndërrimeve të stacioneve në Mitrovicë Jugu dhe Vushtri, në të gjitha stacionet tjera, njësitë patrulluese në ditën e inspektimit kanë aplikuar raportimin në fund të ndërrimit përmes fletë patrullave. (f) Logu në disa stacione po vazhdon të mos ketë cilësinë e duhur sa i përket futjes e përditësimit të të dhënave. Janë evidentuar raste kur në mungesë të personelit kompetent dhe mungesës së qasjes në Sistem, nga disa stacione nuk po mbahet kjo evidencë në ndërrim, ose që mbahet në kohë joreale. (g) Krahasuar me matjet e vitit 2022 kur është analizuar koha e reagimit policor për të gjitha stacionet, nga matjet e fundit edhe pse rrjedhin nga një mostër më e reduktuar dhe të fokusuar në një ditë të vetme, pasqyrohet një kohë e shkurtuar e reagimit policor. (h) Përgjithësisht gjysma e kontingjentit të automjeteve të stacioneve policore janë identifikuar si jo funksionale për shkak të gjendjes teknike jo të mirë. Edhe pse shumica prej stacioneve kanë pasur kapacitete të mjaftueshme në funksion të ndërrimit, ka pasur disa të tjera që kapacitetet e tilla i kanë pasur më të kufizuara.
--	--

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore ⁵ (në original)	Plani i veprimit
1.	Marrë parasysh tejkalimet dhe mungesat në numrin e punonjësve të stacioneve të inspektuara, IPK i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Personelit dhe Administratës që të ndërmarrë hapat e nevojshëm drejt përmbylljes së procesit të sistemimit dhe risistemimit të burimeve njerëzore, konform Rregullores (MPB) Nr. 02/2023 për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës të Policisë së Kosovës.	-I-	Departamenti i Burimeve Njerëzore është në përfundim të futjes në sistem të të dhënave të personelit në bazë të strukturës së re organizative, andaj pritet që fillimi i muajit Prill të gjej sistemin e ri të lëshuar me strukturën e re. Gjithashtu, stacionet policore të të gjitha kategorive e kanë limitin e tyre të numrit të personelit prej- deri dhe në bazë të asaj nuk kemi numër të madh të policëve nëpër stacione, respektivisht rajone.	K-II 2024
2.	IPK i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Personelit dhe Administratës, që në koordinim me drejtoritë rajonale policore të plotësojnë nevojat e stacioneve me burime njerëzore siç parashihen me Listën e Personelit të Autorizuar (vëmendja duhet përqendruar tek stacionet, si: Fushë Kosovë, Kaçanik dhe Shtime).	-I-	Departamenti i Burimeve Njerëzore është në përfundim të futjes në sistem të të dhënave të personelit në bazë të strukturës së re organizative, andaj pritet që fillimi i muajit Prill të gjej sistemin e ri të lëshuar me strukturën e re. Në stacionet e potencuara do të jetë vëmendje e shtuar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore.	K-II 2024
3.	IPK iu rekomandon komandantëve të stacioneve policore në Suharekë, Prizren Veriu, Kaçanik, Deçan, Gjilan, Prishtinë Jug, Prishtinë Qendër dhe Ferizaj, që të angazhohen për një menaxhim më cilësor të burimeve njerëzore brenda ndërrimeve.	-II-	Komandantët dhe Shefat Operativës së stacioneve policore përkatëse do të kryejnë inspektime në baza ditore lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore në ndërrime.	Në vazhdimësi
4.	IPK iu rekomandon komandantëve të stacioneve policore në Mitrovicë Jug dhe Vushtrri, që të kërkojnë nga njësitë patrulluese që në përfundim të ndërrimeve të pëmbushin obligimet e tyre në raportimin e aktiviteteve të ndërmarrja policore përmes fletëve patrulluese (raportet e patrullave).	-I-	Komandantët dhe Shefat Operativës së stacioneve policore përkatëse do të kryejnë inspektime në baza ditore lidhur me menaxhimin e udhëheqësve të njësisve patrulluese dhe kontrollimin e fletave patrulluese për paraqitjen e saktë të angazhimeve ditore në këto fletë patrulla.	Menjëherë Mbikëqyrje në vazhdimësi
5.	Për shkak të aplikimit të praktikave të ndryshme të mbajtjes së evidencës së Logut operacional, IPK i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Operacioneve, që të shpërndajë informatën sqaruese në të gjitha drejtoritë rajonale dhe qendrat e radio komunikimit, mbi llojin e evidencave që duhet mbajtur lidhur me thirrjet dhe raportimin, por edhe përmbytjen e informatave brenda	-I-	Drejtori i Departamentit të Rendit Publik me një shkresë të veçantë do të ua sqaroj Drejtorive Rajonale pikat e kërkuara në këtë Rekomandim edhe pse të njëjtat janë të sqaruara përmes manualit të veçantë për çështje të tilla.	K-II 2024

⁵ Komentet e strukturës policore janë përmbyllje të tekstit autentik të saj dhe në to nuk ka pasur ndërrime. Komentet janë pranuar me shkrim pas takimit përmbyllës të datës 28.03.2024, të realizuar nga përfaqësues të Departamentit të Inspektimit të IPK-së dhe strukturës policore të inspektuar.

<i>tyre (në disa stacione mbahet logu i reduktuar me informata, por edhe info ditore, derisa në shumë të tjera mbahet vetëm logu operacional).</i>					
--	--	--	--	--	--

Shtojca

Shtojca 1 - Të dhëna mbi burimet njerëzore të stacioneve policore sipas kategorive (31.12.2023)				
Kategoria	LPA	Gjendja aktuale	Ndryshimi (+/-)	Përqindja (%)
A	1.123	1.413	+290	+20.5%
Ferizaj	116	156	+40	+25%
Fushë Kosovë	126	119	-7	-5.5%
Gjilan	123	184	+61	+33.1%
Mitrovicë Jugu	127	148	+21	+14.1%
Pejë	146	165	+19	+11.5%
Prishtinë Qendër	115	178	+63	+35.4%
Prishtinë Jugu	120	184	+64	+34.4%
Prishtinë Veriu	116	123	+7	+5.7%
Prizren	134	156	+22	+14.1%
B	519	575	+56	+9.7%
Deçan	72	74	+2	+2.7%
Kaçanik	64	57	-7	-10.9%
Kamenicë	79	81	+2	+2.4%
Prizren Veriu	53	54	+1	+1.8%
Suharekë	84	83	-1	-1.2%
Viti	78	81	+3	+3.7%
Vushtrri	89	145	+56	+38.6%
C	59	48	-11	-18.6%
Shtime	59	48	-11	-18.6%
Gjithsej	1.701	2.036	+335	+16.4%

Shtojca 2 - Tabelë përmbledhëse mbi burimet e angazhuara nga stacionet policore (08.02.2024)			
Kategoria	Ndërrimi II		
	Burimet e ndërrimit	Burimet aktive	Kapaciteti (%)
A	245	182	74.3
Ferizaj	23	16	69.5
Fushë Kosovë	21	16	76.1
Gjilan	22	14	63.6
Mitrovicë Jugu	31	30	96.7
Pejë ⁶	21	15	71.4
Prishtinë Qendër	29	20	68.9
Prishtinë Jugu	45	30	66.6
Prishtinë Veriu	25	20	80
Prizren	28	21	75
B	98	70	71.4
Deçan	11	7	63.6
Kaçanik	8	5	62.5
Kamenicë	15	13	86.6
Prizren Veriu	7	3	42.8
Suharekë	15	6	40.0
Viti	18	13	72.2
Vushtrri	24	23	95.8
C	9	7	77.7
Shtime	9	7	77.7
Gjithsej	352	259	73.5

⁶ Stacioni Policor-Pejë aplikon punën me tre ndërrime nga tetë (8) orë (00:00-08:00, 08:00-16:00 dhe 06:00-00:00)

Shtojca 3 - Metodologjia e aktivitetit patrullues policor në stacionet e inspektuara (08.02.2024)			
Stacioni	Numri i patrullave	Patrullime me automjete	Patrullime në këmbë
A	38	20	18
Ferizaj	5	2	3
Fushë Kosovë	2	1	1
Gjilan	4	2	2
Mitrovicë Jug	4	2	2
Pejë	3	3	0
Prishtinë Jug	6	1	5
Prishtinë Qendra	5	3	2
Prishtinë Veri	4	2	2
Prizren	5	4	1
B	14	11	3
Deçan	1	0	1
Kaçanik	1	1	0
Kamenicë	3	2	1
Prizren Veri	1	1	0
Suharekë	1	1	0
Viti	2	2	0
Vushtrri	5	4	1
C	2	1	1
Shtime	2	1	1

Shtojca 4 - Funkcionaliteti i parkut të automjeteve dhe disponueshmëria				
Kategoria/ Stacioni	Numri i automjeteve			
	Gjithsej	Jo Funktionale	Funktionale	Në dispozicion të ndërrimit
A	123	64	59	44
Ferizaj	19	11	8	5
Fushë Kosovë	10	3	7	2
Gjilan	15	9	6	5
Mitrovicë Jug	16	7	9	8
Pejë	15	9	6	6
Prishtinë Jug	13	10	3	3
Prishtinë Qendër	12	5	7	5
Prishtinë Veriu	7	2	5	4
Prizren	16	8	8	6
B	47	18	29	21
Deçan	4	2	2	1
Kaçanik	5	0	5	4
Kamenicë	5	1	4	4
Prizren Veriu	7	3	4	1
Suharekë	9	5	4	2
Viti	6	2	4	3
Vushtrri	11	5	6	6
C	6	3	3	2
Shtime	6	3	3	2
Gjithsej	176	85	91	67